

Aktet për të cilët është e detyrueshme zhvillimi i konsultimit publik

Ligji “Për njoftimin dhe konsultimin publik” rregullon procesin e njoftimit dhe të konsultimit publik të projektligjeve, projektdokumenteve strategjike kombëtare dhe vendore, si dhe politikave me interes të lartë publik. Të detyrueshme për konsultim janë:

buxheti dhe ndryshimet e tij (programet buxhetore afatmesme dhe projektbuxhetet vjetore)

taksat e tarifat vendore

tjetërsimi ose dhënia në përdorim të pronave të tretëve

rregullorja e brendshme e funksionimit të këshillit të bashkisë

normat, standardet dhe kriteret për rregullimin dhe disiplinimin e funksioneve të këshillit të bashkisë që i janë dhënë atij me ligj, si dhe për mbrojtjen e garantimin e interesit public.